Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/715
Datë: 16.11.2023

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, Rregulloren Nr. 01/2020 për përcaktimin e procedurave për Aplikim të Institucioneve të Arsimit dhe Aftësimit Profesional për akreditim institucional, validim dhe aprovim të kualifikimeve sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe për aplikim të institucioneve që zbatojnë Njohjen e Mësimit Paraprak, neni 5 paragrafi 4, 5 dhe 6, si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 05.10.2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **REFUZOHET** Aplikacioni/kërkesa e Kolegjit Aga Xhite Nr. 01/114 e datës 17.03.2023, me adresë: Rr. "Haki Stërmilli nr.1, në Ferizaj, për akreditim dhe validim për kualifikimet:

- Teknik i Dhëmbëve
- Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë
- Asistent i Fizioterapisë
- Mekatronikë-Operator i robotëve industrial
- Shkenca Kompjuterike

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Kolegjit "Aga Xhite" me adresë: Rr. Haki Stërmilli nr.1, në Ferizaj, me datë 17.03.2023 ka parashtruar në AKK aplikacionin/kërkesën nr. 01/114 për akreditim dhe validim të kualifikimeve: Teknik i Dhëmbëve, Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë, Asistent i Fizioterapisë, Mekatronikë-Operator i robotëve industrial dhe Shkenca Kompjuterike.

Ekspertet e AKK-së brenda afatit ligjor kanë marrë në shqyrtim për vlerësim aplikacionin e dorëzuar nga ana e Kolegjit "Aga Xhite" dhe kanë hartuar raport vlerësues.

Me datë 23.06.2023, ekspertet e AKK-së përmes emalit zyrtar këtë raport i kanë dërguar Kolegjit "Aga Xhite" dhe koordinatores për cilësi në këtë institucion duke kërkuar që aplikacioni të plotësohet brenda afatit ligjor në përputhje me paragrafin 3 të nenit 7 të Rregullores Nr. 01/2020 për përcaktimin e procedurave për aplikim të institucioneve të arsimit dhe aftësimit profesional për akreditim institucional, validim dhe aprovim të kualifikimeve sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe për aplikim të institucioneve që zbatojnë njohjen e mësimit paraprak, sipas udhëzimeve të eksperteve të AKK-së në raport, dispozitave ligjore si dhe kritereve dhe standardeve të përcaktuara nga AKK, dhe aplikacionin me përmirësimet e bëra ta dërgojnë në AKK për vlerësim.

AKK edhe pas përpjekjeve të shumta përmes email-it dhe numrit kontaktues të telefonit nuk ka pranuar asnjë përgjigje nga ky institucion lidhur me këtë çështje, prandaj aplikacioni/kërkesa e institucionit bashkë me raportin e eksperteve të AKK-së është proceduar për vendimmarrje në mbledhjen e Këshilli Drejtues të AKK-së, me të cilin është njoftuar Këshilli Drejtues se Kolegji "Aga Xhite" nuk plotëson kriteret për të kaluar fazën e parë për të hyrë në proces të validimit dhe akreditimit për shkak të mos plotësimit të kritereve siç parashihet me legjislacionin në fuqi të AKK-së.

Andaj, bazuar në këto rrethana dhe në dispozitat ligjore në fuqi Këshilli Drejtues i AKK-së, lidhur me aplikacionin e Kolegjit "Aga Xhite", pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës si dhe raportin vlerësues të eksperteve të AKK-së vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Kolegjit Aga Xhite
2. Arkivit të AKK-së.

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK-së